

Statistikat e Bujqësisë 2021

Tiranë, më 24 Qershor 2022: Në vitin 2021, prodhimi i perimeve është 1.338.218 tonë, duke shënuar rritje vjetore me 3,28 %, krahasuar me vitin 2020. Niveli më i lartë i prodhimit të perimeve është në qarqet Fier me 541.792 tonë, Tiranë me 133.579 tonë dhe Berat me 131.830 tonë.

Tab.1 Prodhimi bujqësor (mijë tonë)

Prodhimi bujqësor	2017	2018	2019	2020	2021
Bimët e arave					
Drithëra	701,7	678,2	666,1	684,0	691,4
Perime	1.151,9	1.166,3	1.258,0	1.295,7	1.338,2
Patate	249,8	254,5	260,7	254,8	258,9
Fasule	21,2	24,5	24,8	25,8	22,4
Bimë industriale	32,7	30,8	33,7	30,1	27,3
Bimë medicinale	12,8	12,5	12,9	14,4	16,0
Foragjere	6.688,6	7.050,1	7.115,2	7.170,5	7.054,0
Drufrutorët					
Pemë frutore	262,6	274,3	272,6	273,7	287,2
Ullinj	107,8	117,6	98,3	131,9	110,2
Agrume	41,0	45,5	46,9	49,2	50,5
Rrush	202,9	184,8	189,9	199,1	212,2


Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Prodhimi i drithërave në vitin 2021 është 691.353 tonë, duke shënuar rritje me 1,04 %, në krahasim me një vit më parë. Niveli më i lartë i prodhimit të drithërave u arrit në qarkun e Fierit me 168.385 tonë, pasuar nga qarqet Elbasan me 98.249 tonë dhe Korçë me 85.094 tonë.

Në vitin 2021, prodhimi i patates është 258.862 tonë, duke u rritur me 1,56 %, në krahasim me vitin 2020. Qarqet që kanë nivelin më të lartë të prodhimit të patates në vend janë, Korça me 63.418 tonë, Fieri me 44.636 tonë dhe Elbasani me 29.986 tonë. Krahasuar me një vit më parë ulje ka shënuar prodhimi i fasules me 12,98 %.

Për publikim 24/06/2022


Fig. 1 Prodhimi i drithërave, perimeve dhe patate (mijë tonë)



Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Perimet e njoma përfaqësojnë 66,48 % të perimeve gjithsej ndjekur nga bostanoret me 24,03 % dhe perimet e thata me 9,48 %.

Fig. 2 Struktura e prodhimit të perimeve, 2021 (në %)



Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural


Në vitin 2021, u prodhuan 889.693 tonë perime të njoma duke shënuar rritje prej 1,69 %, gjithashtu prodhimi i bostanoreve dhe perimeve të thata kanë shënuar një rritje respektivisht me 7,60 % dhe 4,11 %, krahasuar me vitin 2020.

Në grupin e perimeve të njoma, kulturat përfaqësuese, janë domatja me 35,35 %, kastravec 13,28 % dhe speci 11,17 %. Në grupin e perimeve të thata, qepa e thatë përfaqëson 85,32 % ndaj prodhimit gjithsej, ndërsa në grupin e bostanoreve shalqini përfaqëson 84,25 % të prodhimit të këtij grupi.

Prodhimi i perimeve në serra përfaqëson 21,67 % të prodhimit gjithsej të perimeve nga ku 52,00 % e këtij prodhimi i përket Qarkut Fier.

Në vitin 2021, prodhimi në serra është rritur me 2,64 %, krahasuar me një vit më parë ku prodhimi i domates zë 51.9 % të prodhimit gjithsej në serra.


Fig. 3 Prodhimi i perimeve në serra sipas kulturave (në %)



Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Qarku me përqindjen më të lartë të prodhimit të perimeve në serra ndaj prodhimit të perimeve gjithsej është Berati me 64,62 % dhe Fieri 27,79 %, përqindja më e ulët është shënuar në qarkun Korçë dhe Gjirokastrë 0,16 % dhe 0,42 %.

Fig. 4 Prodhimi i perimeve në fushë dhe serrë, sipas qarqeve 2021 (në %)




Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Drufrutorët

Prodhimi i drufrutorëve përfaqësohet nga prodhimi i pemëve frutore, ullinjve, agrumeve dhe rrushit.

Fig. 5 Prodhimi i drufrutorëve (mijë tonë)




Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Prodhimi i pemëve frutore në vitin 2021 është 287.210 tonë duke u rritur me 4,92 %, krahasuar me vitin 2020. Niveli më i lartë i prodhimit të pemëve frutore u arrit në qarkun e Korçës me 89.753 tonë pasuar nga qarqet Elbasan me 39.118 tonë dhe Fier me 33.774 tonë.

Grupi i pemëve frutore me farë zë 45,43 % të prodhimit, peshën kryesore në këtë grup e zë prodhimi i mollëve me 85,25 %. Qarku i Korçës zë 66,02 % të prodhimit të mollëve gjithsej në vend.

Fig. 6 Struktura e prodhimit të pemëve frutore sipas llojeve dhe qarqeve, 2021 (në %)



* Përfshihet prodhimi i manave dhe të tjera

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Në grupin e pemëve frutore me bërthamë, peshën më të madhe e zënë prodhimi i kumbullave me 46,33 % të prodhimit të këtij grupi, pasuar nga qershitë me 24,80 % dhe pjeshkët me 23,18 %.

Në grupin e pemëve frutore subtropikale, peshë kryesore zë prodhimi i fiqve me 51,40 % pasuar nga shegët me 17,76 %.

Niveli më i lartë i prodhimit tek pemët frutore arvore është shënuar në Qarkun e Kukësit, peshën kryesore në këtë grup e zënë arrat me 46,37 %, pasuar nga gështenjat me 33,96 %.

Në vitin 2021, u prodhuan 110.164 tonë ullinj, duke shënuar rënie me 16,52 %, krahasuar me një vit më parë. Niveli më i lartë i prodhimit të ullirit u arrit në qarkun e Fierit me 34.241 tonë pasuar nga qarqet Elbasan me 21.102 tonë dhe Vlorë me 20.298 tonë. Varietet e ullirit për vaj përfaqësojnë 87,60 % të prodhimit gjithsej dhe varietetet e ullirit për tavolinë përfaqësojnë 12,40 %.

Niveli më i lartë i prodhimit të agrumeve është shënuar në qarkun e Vlorës me 64,41 % (32.518 tonë).

Prodhimi i agrumeve në vitin 2021 është 50.485 tonë me një rritje prej 2,61 %, krahasuar me një vit më parë, ku 65,04 % të prodhimit gjithsej të agrumeve e zënë mandarinat.

Në 2021, prodhimi i rrushit është 212.011 tonë duke shënuar një rritje me 6,50 %, krahasuar me një vit më parë, ky prodhim përfaqësohet nga rrushi i vreshtave me 60,51 % dhe rrushi i pjergullave me 39,49 %.

Metodologjia

Statistikat e bujqësisë për vitin 2021 mbështeten në informacionin administrativ, të mbledhur nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Baza ligjore për mbledhjen e statistikave bujqësore është Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare dhe Programi i Statistikave Zyrtare 2017-2021, gjithashtu duke zbatuar klasifikimet dhe përkufizimet sipas rregulloreve Evropiane përkatëse -Rregullorja Evropiane (KE) Nr. 543/2009 mbi Statistikat e Bujqësisë.

Informacioni mblidhet në terren nga specialistët e ekstensionit në të gjithë vendin. Këta specialistë mblidhin të dhëna drejtpërdrejt nga fermerët. Prodhimi bujqësor është sinonim me prodhimin e vjelë dhe përfshin sasi të shitura, konsumin direkt në familjet fermere, humbjet dhe mbetjet në fermë, si dhe humbjet gjatë transportit, ruajtjes dhe paketimit.

Statistikat e bimëve i referohen të dhënave vjetore si: sipërfaqe e kultivuar, sipërfaqe prodhuese për drufrutorët, prodhim dhe rendiment.

Të dhënat e grumbulluara dërgohen në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ku specialistët e prodhimit bimor bëjnë vlerësime duke krahasuar të dhënat e grumbulluara nga terreni me të dhënat e fermave në vite.

Përkufizime

Viti i prodhimit

Me vit prodhim i nënkuptojmë vitin kalendarik në të cilin fillon vjelja e prodhimit.

Klasifikimi

Klasifikimi i bimëve të arave bëhet sipas grup kulturash (drithëra, perime, bimë industriale, foragjere, farëra vajore, patate, fasule) në fushë të hapur dhe serra, kulturë e parë dhe e dytë.

Klasifikimi i drufrutorëve bëhet sipas grupeve kryesore: pemët frutore, ullinj, agrume, vreshta dhe pjergulla për numrin e pemëve gjithsej, pemët në prodhim, prodhimin dhe rendimentin.

Sipërfaqja e kultivuar

Sipërfaqja e kultivuar korrespondon me sipërfaqen totale të mbjellë për prodhimin e një kulture bujqësore, specifike gjatë një viti kalendarik të dhënë. Sipërfaqja e kultivuar përfshin sipërfaqet e mbjella me kulturave të para dhe të dyta. Sipërfaqja e perimeve gjithsej përfaqësohet nga sipërfaqja e perimeve të njoma, të thata dhe bostanoreve. Nga kjo sipërfaqe përjashtohen sipërfaqet e dëmtuara nga dëmtues natyror (përmytjet, zjarre etj)

Serrë

Serrë është ambienti i mbuluar me xham apo me mbulesë të lartë, (që lejon kalimin e personave apo mjeteve mekanike), të fiksuara apo të lëvizshme (xham ose plastikë e fortë ose fleksibël), ku bimët kultivohen gjatë gjithë periudhës apo për pjesën më të madhe të rritjes saj.

Pemët frutore

Pemët frutore përfaqësohen nga frutat farore (mollë, dardhë, ftua), Frutat bërthamore(kumbulla, qershi, pjeshkë, kajsi), frutat subtropikale(fiq, hurma, shegë), frutat arnore (arra, gështenja, bajame dhe lajthi), dhe te tjera.

Sipërfaqja prodhuese

Sipërfaqja prodhuese e drufrutorëve është sipërfaqja potenciale prodhuese. Përfshihen sipërfaqet e pemëtoreve të reja, blloqet e drufrutorëve extensive dhe të degraduara.